



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Procesverbal nga Mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) i mbajtur me datë 26.05.2022

R E N D D I T E :

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Vlerësim mbi çështjen e sigurisë në Komunën e Prishtinës, informatë nga Policia e Kosovës;
3. Situata në Komunë me ndriçim, parkingje, pastrim të rrugëve dhe mbeturinave;
4. Informatë mbi punën e Këshillave Lokal të Sigurisë Publike në Prishtinës (KLSP);
5. Të ndryshme

Z. Përparim Rama Kryetar i Komunës se Prishtinës e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit, dhe i njoftojë me rendin e ditës.

Nën udhëheqjen e Kryetarit Përparim Rama, është mbajtur mbledhja e radhës e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Prishtinës. Në këtë takim në të cilin morën pjesë përfaqësuesit komunal, përfaqësuesit e këshillave të bashkësisë, përfaqësuesit e komuniteteve, përfaqësuesit e grupeve fetare, përfaqësues nga Policia e Kosovës, etj.

Fillimisht kryesues i këtij takimi, z. Rama theksoi se është privilegji që merr pjesë në këtë takim. Si rrjedhojë ai pyeti të pranishmit nëse kanë për të shtuar ndonjë tematik për ta vendosur si pikë e rëndit të ditës për tu diskutuar në këshill.

Rendi i ditës u miratua pa asnjë votë kundër dhe pa asnjë abstenim.

Pika 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Fjalën e kërkon z. Hetem Kupina.

z. Hetem Kupina, ekstrakti është përmbytjesor dhe i kompletuar ne te gjitha mënyrat, kërkesa ime është që procesverbalin ta reduktoni dhe do të ishte mire që ai të ketë konkluzion.

z. Rama, faleminderit!

Vazhdojmë me votim te pikës së parë të rendit te ditës.

Miratohet pika e pare e rendit te ditës.

Pika 2. Vlerësim mbi çështjen e sigurisë në Komunën e Prishtinës, informatë nga Policia e Kosovës

Fjalën e merr komandanti i stacionit policor Veriu, falënderojmë Komunën e Prishtinës, kryetarin Rama, me rastin e ofrimit te pronës komunale të Prishtinës në shfrytëzim për dislokim të stacionit policor veriu.

Sa i përket stacionit policor të zonës veri, situata është e qete dhe ne bashkëpunim me mekanizmat tjera nuk ka gjasa për ndonjë eskalim te mundshëm edhe ne te ardhmen.

Periudha kohore e raportimit është dy mujore dhe përcillet me ngritje te lehte te rasteve kundër të pasurisë, dhunës ne familje, aksidentet ne komunikacion dhe përdorimi i narkotikeve.

Përmes planeve operative qe ne i kemi ne drejtim te veprave penale kundër pasurisë është arritur te arrestohen individ dhe grupe te organizuara te dyshuara për këto raste.

Dhuna në familje është ne ngritje e sipër gjithashtu dhe veprat penale, është problem me ardhur ne përfundim a kemi një vetëdijesim te komunitetit ne raportim e këtyre rasteve, apo kemi një ngritje të dhunës ne familje.

Shqetësuese është përdorimi i narkotikeve dhe prezenca e tyre është ne ngritje. Me qellim te parandalimit te këtyre dukurive prezencia jone ne shkolla është shtuar, dhe gjatë kësaj periudhe dymujore nuk kemi pas incidente.

Gjendja e sigurisë ne komunikacion, kemi adresuar disa çështje te cilat kane pasur te bëjnë me infrastrukture rrugore ku janë sanuar dhe është intervenuar, disa çështje kane mbetur peng ne mungese te kontratatave ne prokurim, për shenjat e komunikacionit.

Sa i përket sigurisë ne trafik kemi plane te ndryshme, dite me pare kemi realizuar një plan me Drejtorinë e Inspeksionit, për parandalim te veprimtarive ilegalë "taxi", dhe besoj qe edhe ne te ardhmen do te jemi prezent me plane te tilla.

Kaq kisha për raportim, faleminderit!

Kapiten Besim Zogiani, zv. Komandant stacioni policor jugu, gjate periudhës raportuese kemi një ngritje te rasteve ndaj pasurisë me vjedhje, sidomos vjedhjes se gjepave ne stacione te autobusëve, ne afërsi te kopshteve te fëmijëve dhe ne vende ku ka me shume njerëz. Gjate kësaj periudhe kemi arrit te identifikojmë personat edhe janë arrestuar ata te cilët i kane kryer këto vepra.

Çështja e sigurisë ne komunikacion ka ngritjet te lehtë, po ashtu dhe ngritjet e shqiptimit te gjobave. Shqetësuese është përdorimi i dukurive negative narkotikëve është ne ngritje, po ashtu ka edhe arrestime te këtyre personave.

Po ashtu Jemi te angazhuar ne ofrimin e sigurisë rreth shkollave për nxënësit, me plane operative konkrete me polic me rroba civile, ku ka një bashkëpunim te ndërsjellët mes nesh dhe menaxhmentit te shkollave, për ofrimin e sigurisë se nxënëseve.

Shqetësim tjetër kryesishet ne stacionin qendra është zhurma prishja e rendit te qetësisë publike, me muzike te larte nga lokalet edhe pas orës 22:00, stacioni policor jugu ka te angazhuar polic edhe ne këtë drejtë. Ju informojmë se ne muajin prill deri ne këtë date te raportimit, janë shqiptuar gjithsej 55 gjoba ndaj personave te cilët kane bere prishjen e rendit te qetësisë publike.

Ne këtë pike kërkoj qe te ketë shtim dhe kontolle, gjate kësaj periudhe sidomos pas orës 22:00, nga inspektoret komunal.

Faleminderit!

Toger Zekeri Januzi, shef i sektorit te operatives, Përshëndetje për te gjithë!

Sa i përket zonës se përgjegjësisë stacionit qendra është një situate e qete, veprat penale kane një rrënje prej diku -26% kundër pasurisë, rastet e ngritura janë te aksidentet ne trafik, për këto raste kemi aktivizuar njësinë e çiklisteve ku janë duke marr masa ne trafik, ndaj shkelësve te ligjt.

Vlen te potencohet ne fund te këtij muajit me dt. 23.05.22, ka ndodh një grabitje një operator "Taxi" dhe policia e stacionit qendër ne bashkëpunim me stacionin veri, kane arritur qe brenda shume pak minutave te arrestojnë tre persona, te konfiskohet arma dhe viktima është trajtuar menjëherë. Kjo ka qene një prej rasteve te suksesshme ne zonën e stacionit policor qendër dhe kjo tregon qe tre stacionet kane një bashkëpunim te shkëlqyeshëm ne kapjen e keqbërësve.

Sa i përket incidenteve serioze, ditëve te fundit kemi pas disa kanosje me mjete shpërthyese sidomos ne

Rektorat policia i ka marr te gjitha informatat e nevojshme, mirëpo fillimisht janë si formacione te rrejshme dhe te njëjtat janë duke u trajtuar ne nivel qendror.

Gjendja e sigurisë ne stacionin qendër, konsiderohet e qete.

Ju falënderoj te gjithëve!

z. Rama, faleminderit!

Vazhdojmë me pikën tre.

Pika tre situata në Komunë me ndriçim, parkingje, pastrim të rrugëve dhe mbeturinave

z. **Habib Qorri, Drejtoria e Shërbimeve Publike**, se pari po fillojmë me ndriçimin publik ekzistues ku nuk jemi ne gjendjen e kënaqshme, se si kemi planifikuar ne fillim te vitit, me planet vjetore te drejtorisë, për shkak te kontratatave qe nuk i kemi ne realizim. Por tani janë ne procedure te vlerësimit, qe shpresojmë brenda një kohe jo te gjate do ti kemi dy projekte edhe projektin e mirëmbajtjen te rrugëve qe është i ndare ne shtate pjesë, po ashtu dhe projektin e ndare ne katër llote, për zgjerimin e ndriçimit neper pjesët ku ende nuk ka ndriçim.

Kemi bere evidentimin e te gjitha rrugëve dhe problemeve te cilat janë ne rrjetin e ndriçimit, në momentin që i kemi kontratat ne realizim, planin e veprimit e kemi te gatshëm për realizimin e sistemit te ndriçimit. Sa i përket parkingjeve rregulloren e kemi ne fuqi e cila është qe nga vitit 2020, ju kane bartur kompetencat "Prishtina Parking", e cila është duke operuar ne bazë rregullores dhe te statutit te ndërmarrjes. Kemi pas shume ankesa dhe probleme te cilat janë paraqitur ne terren, gjë qe i kemi evidentuar dhe e kemi pare te nevojshme qe gjithsesi rregulloja duhet te hyje ne draft te ri dhe te rregullohen te gjitha problemet qe na janë shfaqur, ne mënyrë qe menaxhimi i parkingjeve te jete sa me funksional.

Për pastrimin e rrugëve, kemi filluar me regjimin e mirëmbajtjes verore te rrugëve, ku janë te kontraktuar 6 kompani, ne 6 lloto ku janë te përfshira te gjitha rrugët e Prishtinës. Ne kuadër te kësaj nuk është vetëm pastrimi i rrugëve, por janë te gjitha te përfshira hapësirat publike, parqet, parkingjet etj.

Tek menaxhimi i mbeturinave, kemi bere largimin e shume deponive ilegale ne qytet dhe ne zona rurale. Kemi bere rehabilitimin e atyre lokacione dhe jemi duke përdorur disa forma te ndryshme te pengimit te hedhjes se ripërsëritur te mbeturinave ne ato vende. Po ashtu ka vazhduar menaxhimi dhe mbikëqyrja e grumbullimit te mbeturinave ku operon ndërmarrja pastrimi, kemi pas probleme me deponin dhe kjo ka reflektuar keq, për arsy se atje është mbyllë porta për hedhjen e mbeturinave. Pas deblokit te problemit qe ka qene me Deponine Regionale, kompania është duke punuar me kapacitet te plote për me sanuar gjendjen.

Faleminderit!

Znj. **Violeta Hasani**, pëershëndesje për te gjithë!

Se pari ankesat tona janë rreth "Prishtina Parking", sjellja e tyre ndaj banoreve rezident, gjobitja është shumë e lartë ndaj banoreve, po ashtu edhe ndaj mërgimtareve. Dëshirojmë te dimë a ka ndonjë forme qe me penguar sjelljen e punëtorëve "Prishtina Parking", apo ndonjë forme me pezulluar deri sa te merret vendim për ndryshime ne Komunën e Prishtinës.

Unë kam hasur ne probleme me ta dhe kam hapur rast ne gjykate, ku prej tyre kam pasur ofendime edhe kërcënime.

Ajo qe me gjëzon shume, qe e përcjell edhe tek banoret është për një kryetar si ju, po ashtu edhe për policinë tone qe gjithmonë e kemi pranë qytetarëve.

Faleminderit!

z. **Habib Qorri**, rregullorja për menaxhimin e parkingjeve e cila është ne fuqi i ka kaluar te gjitha procedurat ligjore, mirëpo ne brengat dhe shqetësimet e qytetareve i kemi te evidentuara, dhe për atë Komuna e ka

pare te nevojshme te hyje ne ridraftimin e rregullores dhe te gjitha ato probleme te cilat janë shfaqur ne terren, te përfshihen dhe te shfuqizohen me rregullore.

z. Rama, ideja e kontrollit te parkingjeve është për përmisimin e jetës te rezidenteve, sjellet e stafit te "Prishtina Parking", duhet me qene profesionale, janë te pa tolerueshme sjelljet e tilla ndaj banoreve. Kemi me pas shume shpejt një takim me qytetar po ashtu edhe "Prishtina Parking", dhe Drejtorinë e Shërbimeve Publike, qe ta kemi te çartë çka po synojmë për me e krijuar një jete sa me te mire për qytetaret tone.

z. Artur Krasniqi- Kisha Protestante, përshëndetje për te gjithë!

Ne rrugën "Rrustem Statovci", ku ne kemi një prej selive tona, ka 2 vite qe ndriçimi ne fillim rrugës nuk punon, kemi bere kërkesë na është thënë qe duhet te presim për procedure te tenderimit, kemi kërkuar me rregulluar vet nuk na është lejuar.

Kemi bere kërkesë ne komune dhe ne polici, qe te vendosen pengesa për ngadalësimin e shpejtësisë, sepse ka pas aksidente deri te futja e veturave ne oborrin e selisë sonë.

Ka ndërtime te larta qe janë bere ne këtë rruge, por nuk ka vend për mbeturina gjendja është kaotike.

Ju lutem ti keni parasysh kërkesat tona.

Sa i përket parkingut, është një veprim shume i mire qe Komuna e Prishtinës e ka marr, për rregullimin e parkingjeve.

Ajo qe na shqetëson është ne komunikim me "Prishtina Parking", ne zyrën tone ne lagjen "Dardania", ata nuk na ofrojnë neve marrëveshje si rezident, se thonë se kjo është për persona fizik, jo për persona juridik. Ne i kemi ofruar dëshmi qe ne jemi pronar te objektit dhe kjo nuk na është marr parasysh.

Shqetësuese është edhe kur merr një ndalese "tikete' prej "Prishtina Parking", se paku duhet me prit 6 ore për lirim te makinës, ku ka raste qe është njoftuar edhe policia, me arsyen qe kane shume pune dhe duhet me ardhur dikush prej zyrës me liruar veturën, sepse ata i mbajnë çelësat.

Këto janë disa prej shqetësimeve tona, ku kemi bere kërkesë po nuk na është kthyer asgjë zyrtarisht vetëm përgjigje me goje.

Faleminderit!

Përfaqësuesi KLSP-së, fshati Keqekolle Ilmi Uka, përshëndetje për te gjithë!

Mirëmbajtja dimërore janë përfshira vetëm 60% te rrugëve kemi ankesa nga qytetaret se pse ne pjesën e mbetur nuk vjen pastruesja e bores. Dëshirojmë te jene te përfshira te gjitha rrugët ne mirëmbajtjen e tyre ne mënyrë te barabartë.

Faleminderit!

Z. Rama, pika është shume me vend, zotëri Qorri e përmendi problemin qe e kemi me ndriçim, për shkak te procedurës se prokurimit.

Kërkesën e juaj e kemi pranuar e kemi ne Drejtorinë e Urbanizimit po e shqyrtojmë aspektin e parkingut kështu e shume shpejt ju lajmërojmë.

Znj. Safije Beseni KLSP-Dodona vendos mbiemrin te lutem, me mbeturina kemi problem sidomos afër parkut te qytetit, pastrimi i rrugëve duhet te behet me shpesh. Ne atë pjesë ka hipermarkete dhe ata i bllokojnë kontejnerët kështu e qytetaret përfundojnë duke hedhur mbeturinat afër kontejnerëve dhe është një gjendje e padurueshme sidomos ne kohen e verës.

Po ashtu tek rruga "Shaip Kamberi" dhe "Mustafe Hoxha", ne këtë pjesë janë shtëpitë e rrënuara ku jetojnë me shume komuniteti rom dhe ato shtëpi janë shndërruar ne deponi te mbeturinave dhe ka shume qen endacak.

Komandanti i stacionit policor Veriu, çështja e sigurisë ne komunikacion ne rrugën "Shkodra", ku është edhe kisha, ju lus përfaqësuesin e kishës çdo here kur ka një shqetësim për çështje te caktuara le te adreson tek

ne.

Faleminderit!

Z. Rama, replike.

Z. Izedin Bajram, i kam katër kërkesa: ndriçimi tek Muzeu Etnologjik, tek shkolla "Elena Gjika" me rregulluar rrugën me kocka, largimi i kafshëve nga qyteti dhe rruga tek "Qafa", kontejner nuk ka te mjaftueshëm.
Faleminderit!

Z. Rama, për ndriçim, e shpjegoj zotëri Qorri do te zgjidhet shume shpejt kjo çështje.

Me shkollën "Elena Gjika", kemi filluar pikërisht ku propozimi është me mbyll rrugën tek shkolla, për me bere një vend te sigurte përfshirë.

Kafshët ne qytet komuna e Prishtinës, është qe vetmja qe po merret me këtë çështje me seriozitetin me te madh, duhet një intervenim gjithëpërfshirës i gjithë territorit te Kosovës, për me u marr me problemin e qenve endacak.

Kontejnerët te pamjaftueshëm, ju kthejmë përgjigje me shkrim.

z. Hetem Kupina, me dëshirën me te madhe qe te kontribuoj ne mirëmbajtjen e punës se takimeve te KLSP-vee, lus te gjithë anëtarët e këshillit qe te gjitha kërkesat qe kane te bëjnë me ekzekutivin komunal te drejtohen me shkrim.

Faleminderit!

Safet Kamberaj KLSP-Dardania vendos emrin te lutem, përshëndetje për te gjithë!

Ne emër te qytetareve te Dardanisë, ju falënderojmë për aksionin për pastrimin e parkingjeve, rrugëve rregullimi i trotuareve, rregullimi i drunjëve etj.

Faleminderit!

Z. Rama, ato intervenime do te jene ne te gjithë territorin e Komunës e Prishtinës, me vjen mire qe i kenë pare si te frytshme dhe pozitive.

Pika e katërt Informatë mbi punën e Këshillave Lokal të Sigurisë Publike në Prishtinës (KLSP)

Lus kryetarët e këshillave te marrin fjalën dhe te raportojnë për punën e tyre.

z. Hetem Kupina, ne cilësinë e kryesuesit te këshillit, ne çdo muaj mbajmë takime te rregulita me anëtarët e Këshillit Lokal për Siguri Publike ne fshatin Bernice me seli ne fshatin Bardhosh ku te pranishëm janë policia KFOR-i etj.

Bazuar ne te dhënat te cilat i kemi deri tani, ne zonën tone te sigurisë gjendja e sigurisë është e shkëlqyer. Problemet infrastrukturore qe kane te bëjnë me ekzekutivin komunal, ato nuk kryhen brenda dite duhet te kemi durim.

Faleminderit!

Znj. Violeta Hasani, komiteti Lokal për Siguri Publike qendër deri me tash qe jemi financuar prej OSBE-se, Ambasada Norvegjeze i kemi realizuar 7 projekte, te cilat i kane shërbyer bashkësisë ne te mire.

Falënderimi i takon stacionit policor qendra i përshëndes te gjithë me te cilët jemi gjithmonë ne bashkëpunim, për situatën brenda zonës qendër.

E shoh një besim te madh te banoreve me qeverisjen e re kommunale kam kërkesë pikërisht me u takuar me ju prej banoreve rezident dhe prej bizneseve. Te gjitha, drejtoritë janë duke i dhen një jehone shume te mire Komunës se Prishtinës.

Faleminderit!

Z. Shefki Rusinovci drejtor i shkollës "Pavarësia", përshëndetje për te gjithë!

Mua me gëzon fakti qe kam te njëtin mendim me komandantët e policisë për sigurinë ne shkolla qe është shume e ndjeshme.

Unë dua te propozoj sot këtu qe komuna me te gjitha institucionet relevante, është mire te hartoj një projekt te sigurisë ne shkolla.

Ne punojmë me ligjërata ne bashkëpunim me policinë, psikolog e te tjerë, por mendoj qe mund te gjendet një mënyrë e hartimit te një platforme se sigurisë unike për Komunën e Prishtinës, me specifikat qe kane shkollat.

Po i përcjell edhe disa shqetësimë te lagjes zhurma ne rrugën B, deri natën vone ora 24:00, duke kërkuar ndihme edhe prej policisë.

Shqetësim për kafiterite, ku dyshohet se përdoren substanca narkotike, dhe rasti me shqetësues ka arritur deri ne shkalle te trafikimit njerëzor me te mitur.

Kërkoj sinqerisht qe organet e sigurisë ta rrisin kontrollin ne ato lokale.

Faleminderit!

z. Ilmi Halili- zv. Kryesues KLSP-Kalabria, përshëndetje për te gjithë!

Ruga tek banesat e arabeve ku zhurma deri ne orët e vona te mëngjesit, ka ndëshkime por përsëri vazhdojnë, kërkojmë qe gjobat te rriten ndaj këtyre dukurive.

Trotuari mungon ne rrugën "Agim Qela", uzurpatoret e kane token afër shkollës prone komunale, ata e kanë thurur atë pjese, nxënësit dalin ne rruge dhe rrezikojnë jetën e tyre.

Linja ndër urbanë 7c, tek Kalabria e ka një rrugëtim qe nuk ju hynë ne pune shume banoreve, sepse aty tek qendra "Dardha", nuk ka stacion për zbritje me hy ne nënkalim me dal ne lagjen "Dardania", është e pamundur. Pritëse neper stacione te autobusëve nuk ka, duhet te pritet ne shi e ne diell.

Ndërtimi i rrugës "12 Qershori", e lidh rrugën "Dëshmorët e Konushevcit", Forenziken e policisë dhe del tek shkolla e mesme Ekonomike, rruga i ka gjatësi diku 700 m dhe është shume e rëndësishme te ndërtohet për banoret e asaj pjese.

Implanti i ujërave te zeza nuk mundemi me shfrytëzuar si rruge mbi te disa gropë janë mbyllur, sepse janë rrezikuar banoret.

E falënderojmë Drejtorinë e Shërbimeve Publike, ku kane marr një aksion për pastrimin e tyre. Ka shume keqpërdorime ne atë rruge ku punëtorët qe punojnë ne Prishtinë i hedhin mbeturinat ne atë rruge.

Kërkesë e banoreve, me iniciuar edhe njëherë me mbuluar këtë rruge dhe me ju lehtësuar banoreve jetesën dhe qarkullimin me te sigurte.

Faleminderit!

Znj. Safija Beseni KLSP-Dodona, takimet i mbajmë çdo muaj, problemet qe ne mundohemi me i trajtuar janë ato qe e rrezikojnë sigurinë e qytetareve. Problemi me i madh është me përdoruesit e substancave narkotike rreth gjimnazit "Sami Frashëri", shkolla "Elena Gjika", qentë endacak po ashtu edhe me persona qe janë pa shtëpi qe jetojnë rrugëve hapin zjarr ne parkun e qytetit, policia gjithmonë reagojnë është ndal kjo dukuri, por aty ka shqetësimë te shumta ku qytetaret nuk janë te lire te shfrytëzojnë parkun.

"Prishtina Parking", banoret kane filluar me u shqetësuar duke i pare problemet e lagjeve tjera me "Prishtina Parking", kane pyetje qe nëse banoret nuk e done "Prishtina Parking", ne lagje a është patjetër ardhja e tyre edhe ne lagjen tone.

Rreth bullizmit, kam njoftime prej prindërve qe shkollat nuk po i raportojnë rastet, për mos me u prish imazhi i shkollës.

Ne si KLSP e re, kemi pak problem me lokacion i shfrytëzojmë hapësirat e ndryshme, po e kane problem me dite qytetaret ku me na gjete.

Faleminderit!

Z. Rama, desha me u ndërlidhë me aspektin e hapësirës ne procesin e fuqizimit te Bashkësive Lokale, nëpërmjet tyre do te krijomë mundësi për hapësirat për takimet e komunitetit për çështje te ndryshme. Faleminderit!

Komandanti i policisë zona qendër, tek çështja e bullizmit zona qendër, dukurit e këqija nuk përfundojnë, mirëpo policia e Kosovës nuk vepron brenda shkollës, vepron jashtë objekteve shkollore. Në takimet qe i kemi me personelin e shkollave ne presim prej tyre qe te na raportojnë.

Ju ftoj te gjithëve ne çdo kohe lirisht te raportoni, kohëve te fundit kemi pasur raste me pak te raportuara ose fare hiq, i kemi trajtuar me profesionalizëm dhe shpresojmë qe këto dukuri te zvogëlohen. Faleminderit!

Përfaqësuesi KLSP-së, fshati Keqekolle, Ilmi Uka ne bashkëpunim me stacionin policor veri i koordinojmë punët dhe i caktojmë mbledhjet te cilat i mbajmë me përfaqësuesit e bashkësive lokale qe e përbejnë një këshill prej 9 anëtarësh.

Kam një kërkesë për ju zotëri kryetar, a do te kemi rastin te ju kemi prezent edhe ne bashkësinë lokale tek ne?

Ne fshatin Gollak shpërnguljet kane ndodh shkaku i infrastrukturës, prandaj na ndihmoni ta popullojmë edhe një here Gollakun.

Faleminderit!

Z. Rama, po ne çdo pjese do te kemi takime, ideja është qe ta zhvillojmë qytetin se bashku.

Faleminderit!

Përfaqësuesi i komunitetit serb Arsic

Z. Arsic Stanisa, më duhet të shpreh mirënjojen time të madhe për Stacionin Policor të Veriut, i cili me të vërtetë është në gjendje gatishmërie sa herë që i bëjmë kërkesë për drejtimin e trafikut kur kemi festat tonë kishtare. Unë kam qenë në Prishtinë për dy vjet si prift, nuk kam pasur asnjë problem personalisht apo për sa i përket vetë kishës, shpresoj të mbetet kështu.

Unë kam lindur këtu në Kosovë, nuk kam ardhur nga nuk e di nga, por jam nga këtu, e di mentalitetin e këtyre njerëzve, më vjen mirë, më vjen shumë mirë që i kam këta njerëz. policët me të cilët kam bashkëpunim jashtëzakonisht të mirë dhe që e bëjnë punën e tyre shumë profesionalisht.

Nuk kam pasur ndërmend të kritikoj punën e policëve që punojnë, por të paralajmëroj për mundësinë e ndonjë problemi. Kemi pasur një rast ku një grua vdekur ne aksident trafiku ku një person ka hyrë në shirit të kundërt dhe e ka goditur. Pastaj kemi pasur rastin tjeter ku një grua është goditur me makinë në vendkalim për këmbësorë, etj. Duhet të kujdesemi pak për sigurinë në këtë kuptim, nuk po flas për vetë kishën, por po flas ekskluzivisht për njerëzit të cilët jetojnë në këtë pjesë, dhe unë gjithashtu jetoj atje vetëm, për këtë arsy.

Më duhet të them edhe një herë se kemi pasur një bashkëpunim jashtëzakonisht të mirë në çdo aspekt, të dielën kemi pasur festën tonë dhe ku punonjësit e policisë e bënë punën e tyre në mënyrë profesionale dhe nuk patëm asnjë ankesë.

Dëshiroj të falënderoj edhe një herë stacionin Veri për punën e tyre profesionale.

Faleminderit.

Altin Gashi kryesues i KLSP-Hajvali mbiemrin te lutem vedose, përshëndetje për te gjithë!

Raporti për KLSP-Hajvali, ne kemi takime te vazhdueshme, përkrahja prej stacionit policor jugu, është maksimale.

Brengat e qytetareve janë te ngjashme kanalizimi, ndriçimi siguria zhurma etj., mirëpo si një pjese qe ka shtrirje te gjere, kërkesa jone është qe te jete një nënstacion policor, qe praninë e tyre ta kemi me afër. Faleminderit!

z. Ilmi Halili- zv. Kryesues KLSP-Kalabria, lagja Kalabria është diku rreth me 45.000 banor, ne shërbuhemi ne Bashkësinë Lokale Dardani, ne te ardhmen kërkojmë qe te ndërtohet një Bashkësi Lokale ne lagjen Kalabri, qe banoret ti marrin shërbimet me lehte.

Znj. **Violeta Hasani**, dëshiroj te cek se nuk mundemi me e fajësuar komunën, për parregullsitë ne lagjet tona sepse ka qytetar qe e hedhin mbeturina jashtë kontejnerëve edhe pse kontejnerët janë aty. Kish qene mire me broshura me njoftimet neper qytet, ose me dënimë për vetëdijesimin e tyre.

Faleminderit!

Z. Rama, faleminderit, pike shume me vend dhe besoj qe ne takimet e komuniteteve edhe institucioneve te komunës me qytetaret, me shtyre këtë çështje përpara për vetëdijesimin e qytetareve.

Kapiten Besim Zogjani, zv. Komandant stacioni policor jugu, tek pika e peste ndryshme i kam dy çështje ti ngrij me qellim qe te ofrohet një siguri me e madhe, mungesa e shenjezimeve horizontale konkretisht ne rrrethrotollime, po mungojmë ndarja e shiritave ku vozitësit i krijojnë ka dy tre radhë, kish qene mire me u shenjezu.

Me ardhjen e një numri shume te madh te bashkatdhetarëve për shkak te rrugëtimit te gjate qe vijnë u shfrytëzojnë kafiterite për relaksim keqbërësit po iu thyejnë veturnat do te ishte mire qe ne takimet qe i keni me qytetare me një fushate mediale te informohen qe gjerat me vlere çantat rrobat mos te i lënë te ekspozuara sepse po jene cak i thyerjeve te veturnave.

Faleminderit!

Z. Rama, ide e mire me bere se bashku me policinë, një fushate vedijesuse me qytetarët.

Z. Betim Abdullahu ushtrues detyre i udhëheqësit te zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, zyra jone ka një bashkëpunim shume te mire me te gjitha komunitetet qe jetojnë ne komunën e Prishtinës. Komiteti përbehet nga anëtarë te asamblesë komunale, te Komunës Prishtinës dhe te gjitha brengat e komuniteteve shtrohen ne këtë komitet.

Si komiteti i kemi caktuar grupet punuese te vizitojen te gjitha shkollat e Komunës se Prishtinës, për te marr informata për te gjithë fëmijët e komuniteteve. Gjithashtu Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, është duke u përgatitur me një buxhet solid, qe ne si zyre posedojmë për infrastrukturën e komuniteteve qe jetojnë ne Komunën e Prishtinës. Jemi duke i përgatitur projektet, ti dorëzojmë ne drejtore përkatëse, te gjitha kërkesat e tyre.

Ne kemi marrëveshje, bashkëpunime me te gjitha organizatat ndërkombëtare qe veprojnë ne vendin tone. Mundem me përgjegjësi te plote me thënë qe nuk kemi hase ne ndonjë problem te sigurisë ndaj komuniteteve.

Edhe një njoftim pasi qe i kemi komandantet e policisë prezent, kemi një rast te kthimit për here te pare ne Komunën e Prishtinës.

Quhet Marija Novakoviq, e kthyer ne banesën e saj ne lagjen Ulpiana është person te cilës ju kane kryer te gjitha procedurat e kthimit, e kemi pyet për siguri ka deklaruar qe edhe banoret e hyrjes e kane mirëpritur. E thash si informate sepse është rasti i pare qe është kthyer mbas 20 vite largim, te gjithë mekanizmat e kane ne fokus si rast.

Faleminderit!

Z. Hetem Kupina, një sugjerim ne piken te ndryshme, te ndryshohet ne pyetje dhe përgjigje.

Kam një kërkesë ne mbledhjen e KKSBB-se, te jene prezent drejtoret e drejtorive: drejtori i Drejtorisë se Pronës, Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Inspeksionit, e Infrastrukturës, e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Arsimit.

Kemi arsyetime te shumta qe kish qene mire me qene prezent drejtorët, sepse me mire zgjidhet situata qe mos me lejuar mosmarrëveshje te shumta ne mes qytetareve.

Z. Rama, te nderuar përfaqësues te Këshillit Komunal për Siguri ne Bashkësi, ju falënderoj te gjithëve për pjesëmarrje, duke shpresuar qe takimet do te vazhdojnë ne këtë mënyrë te cilat do te ndikojnë ne përmirësimin e sigurisë se qytetareve te Komunës se Prishtinës.

Faleminderit!

Proces Mbajtësja:

Edona Krasniqi



Kryetari i Komunës

Përparim Rama

